**R E P U B L I K A  E  S H Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA DURRËS**
**KËSHILLI BASHKIAK**

# VENDIM

Nr. 102, datë 29.09.2022

**PËR**
**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 54, DATË 31.05.2022, "PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR T'U DREJTUAR KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR NJË NDRYSHIM TË VKM-SË NR. 295, DATË 2.5.2012 "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS ISHËM, TË QARKUT TË DURRËSIT", DHE MIRATIMIN E PËRDITËSIMIT PJESOR TË PASURISË ME EMËRTIMIN KOPSHTI BIZË, QË MBAN NR. 12 TË LISTËS SË TRANSFERIMIT"**

Bazuar në ligjin nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, shkresës nr.12980/1 prot., datë 18.7.2022, ardhur nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 54, datë 31.05.2022, i konfirmuar nga prefekti për bazueshmërinë ligjore me shkresën nr.474/11 prot., datë 07.06.2022, sipas relacionit të pregatitur nga Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**
**V E N D O S I :**

1. Miratimin për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 54, datë 31.05.2022,"Për miratimin e kërkesës për t'u drejtuar Këshillit të Ministrave për një ndryshim të VKM-së nr.295, datë 2.5.2012, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Ishëm, të Qarkut të Durrësit", dhe miratimin e përditësimit pjesor të pasurisë me emërtimin kopshti Bizë, që mban nr. 12 të listës së transferimit", si më poshtë:

a) Ndryshimin e sipërfaqes ndërtimore nga 181 $m^2$, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 54, datë 31.05.2022, bëhet 240 $m^2$, nga ku $S1=181m^2$ dhe $S2= 59m^2$, sipas planit të rilevimit dhe është pjesë e këtij vendimi.
b) Ndryshimin e sipërfaqes së truallit të lirë (funksional) nga 2650 $m^2$, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 54, datë 31.05.2022, bëhet 2463 $m^2$, sipas planit të rilevimit dhe është pjesë e këtij vendimi.
c) Zëvendësimin e planrilevimit dhe të formularit të inventarizimit, që i bashkëlidhet Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 54, datë 31.05.2022, me planrilevimin dhe formularin e inventarizimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky vendim është pjesë e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 54, datë 31.05.2022.

3. Ngarkohet Drejtoria Ligjore (Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve) për ndjekjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DURRËS

**U shpall sot me datë 30.09.2022**

# 1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

**(Per inventarizimin e pronave te veçanta)**

Bashkia : **Durres**

Njesia Administrative **Ishem**

Fusha e perdorimit te Prones: Arsim

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DURRËS

Identifikoi: Per Bashkine Durres: Kadri Gjyli (Administrator)

Fation Zeqiri, Ervis Bahiti, Ardita Molla, Jetmir Kurti, Anila Muhja (Specialitē)

Per ASHK-ne: Leonard Dervishi (Specialist)

Supervizoi: Irma Bushi Pergj. i Zyres se Pronave

Elio Jani Drejtoria Ligjore

Aprovoi: Emiriana Sako Kryetar I Bashkise

(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

| Nr. Rend. | A | | | B | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes | Nr. Pasurise | Lloji i Prones | Emri i Prones Adresa | Sip. Totale e Prones (m2) | Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2) | Funksioni per te cilin perdoret Prona | Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative | Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit | Te dhena te tjera (Shenime te veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 12 | 1204<br>K-34-88-(82-B)<br>K-34-88-(82-A) | 119 | Truall<br>Ndertese | Kopesht<br>Bize Nj.Administrative Ishem<br>Bashkia Durres | 2463 | 240 | Arsim<br>parashkollor | Bashkia<br>Durres | Bashkia<br>Durres | Sip=2463m2 eshte pjese e pasurise 119<br>S1 objekt 2 kat = 181m2<br>S2 objekt 1kat= 59m2 |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |

# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI _SHTET_ DATE 16/09/2022 QELLIMI_PER REGJISTRIM

| VENDNDODHJA | | | | |
|---|---|---|---|---|
| BASHKIA DURRES | DVASHK/ZVASHK DURRES | ZONA KADASTRALE 1204 | NUMRI PASURISE 119 | INDEX HARTE K-34-88(82-A) K-34-88(82-B) |
| TE DHENAT E PASURISE | | | | |
| LLOJI PASURISE TRUALL | SIP.PASURISE=6000 m2 | SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT=- m2 | NUMRI KATEVE - | NUMRI PEMEVE______ |

X 461712
Y 4602605

## KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X 462447
Y 4602605




X 461712
Y 4602159

SH 1:2500

X 462447
Y 4602159

| Nr. | ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | SHENIME TE REALIZUESIT |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | V | | | 119, 121 | | |
| 2 | J | | | 119 | | |
| 3 | L | | | 119 | | |
| 4 | P | | | 119, 376 | | |

REALIZOI PER BASHKINE DURRES

PUNOI: KADRI GJYLI
FATJON ZEQIRI
ERVIS BAHITI
ARDITA MOLLA
JETMIR KURTI
ANILA MUHJA
PERGJEGJES: IRMA BUSHI
NENSHKRIMI
DREJTORI : ELIO JANI
NENSHKRIMI
KRYETAR: EMIRIANA SAKO
NENSHKRIMI

REALIZOI PER ASHK

SPECIALISTI L. Derviši

DVASHK _______

NENSHKRIMI _______

KONFIRMOI

PERGJEGJESI/DREJTORI_____

NENSHKRIMI / VULA _______

TEKNOLOGJIA E MATJEVE:___________

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT:_KP;HK.

Kode per percaktimin e kufirit:P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

PLANI I RILEVIMIT U HARTUA PER REGJISTRIMIN E PRONES DUKE U BAZUAR NE VKM 295 DATE 05.02.2012 "PER MIRATIMIN E LISTES PERFUNDIMTARE TE PRONAVE TE PALUAJTSHME PUBLIKE,SHTETERORE QE TRANSFEROHEN NE PERDORIM OSE NE PRONESI TE KOMUNES ISHEM QARKU DURRES, NE URDHERIN E BASHKISE DURRES NR.35, DT.25.01.2022 SI DHE NE SHKRESEN E ASHK-SE DREJTUAR BASHKISE DURRES NR. 561 DT.28.03.2022. Siperfaqja prej 2463 m2 eshte pjese e pasurise 119

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI____________

NENSHKRIMI ________

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale

8

BASHKIA DURRËS
07/10/22 7491/7

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT DURRËS**

Nr. 776/7 prot.

Durrës, më 07.10.2022

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK**
**DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË**
**DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.102 datë 29.09.2022 :

Për disa ndryshime në VKB Nr 54 dt 31.05.2022 "Për miratimin e kërkesës për t'ju drejtuar Këshillit të Ministrave për një ndryshim të VKM Nr 295 dt 02.05.2012 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Ishëm, të qarkut të Durrësit" dhe miratimin e përditësimit pjesor të pasurisë me emërtimin Kopshti Bizë, që mban nr 12 të listës së transferimit"

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**
**EMILJAN JANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS